



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

Plani i Integruar i Ministrisë 2008

Shkurt 2008

Mesazhi i Ministrit



Sfida që ka marrë shteti shqiptar në kuadrin e integritimit në strukturat euro-atlantike pa dyshim që ka në fokusin e saj si një objektiv prioritar edhe fushën e drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë për vitin 2008 është angazhuar në kryerjen e disa reformave të thella në sistemin e drejtësisë. Këto reforma konsistojnë në marrjen e masave me karakter ligjor, institucional dhe administrativ, të cilat synojnë në forcimin e shtetit ligjor, rikthimin e besimit të qytetarëve te drejtësia, lufta pa kompromis kundër korrupsionit dhe transparenca e punës së organeve të drejtësisë.

Prioritetet që do të jenë në fokus të këtyre reformave, të cilat do të ndërmerren në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, janë përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e drejtësisë dhe përfrimi i tij me standardet ndërkombëtare, lufta kundër shfaqjeve korruptive në organet e drejtësisë nëpërmjet inspektimeve të vazhdueshme, transparenca në punën e organeve të drejtësisë, përmirësimi i kushteve të jetesës dhe trajtimit të të dënuarve, intensifikimi dhe efica e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, përmirësimi i infrastrukturës së gjyqësorit, modernizimi dhe automatizimi i regjistrimit të pronës së paluajtshme, ekzekutimi i shpejtë i vendimeve gjyqësore, publikimi i shpejtë i akteve normative, përfundimi i shpejtë i detyrimit ligjor të procesit kthimit dhe kompensimit të pronës etj.

Si përfundim, realizimi me sukses i objektivave të parashtruara në këtë plan do të jenë në vëmendjen tonë të vazhdueshme me qëllim përmbushjen në këtë mënyrë të misionit tonë aq sa fisnik dhe të rëndësishëm në konsolidimin e shtetit të së drejtës.



Pasqyra e lëndës

| | | |
|---------|---|----|
| 1 | Misioni i Ministrisë | 4 |
| 2 | Dokumenta strategjike të Ministrisë | 6 |
| 3 | Programet buxhetore të Ministrisë | 7 |
| 4 | Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008..... | 8 |
| 5 | Plani i Monitorimit të Ministrisë | 13 |
| Aneks 1 | Projekt-ligjet për tu paraqitur..... | 14 |
| Aneks 2 | Rezultate që lidhen me Integrimin European | 15 |
| Aneks 3 | Investimet publike | 16 |
| Aneks 4 | Projekte të ndihmës së huaj | 18 |
| Aneks 5 | Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit | 19 |

1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale a civile, mbikëqyrjen e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Ministria e Drejtësisë ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë.

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me ligjin, mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me organet e pushtetit gjyqësor dhe me prokurorinë, duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë.

- Ndjek dhe përgjigjet për realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë.
- Harton projektet e akteve ligjore e nënligjore në fushën e drejtësisë.
- Jep mendim të specializuar për projektet e akteve ligjore dhe të akteve nënligjore normative të KM, ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të tjera qëndrore si dhe për realizimin e reformimit të legjislacionit në përgjithësi.
- Realizon dhe ndjek marrëdhëniet e Ministrisë së Drejtësisë me organet e sistemit të drejtësisë, në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga instrumentet e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.
- Përkthimin zyrtar të akteve ligjore dhe materialeve të tjera në funksion të marrëdhënieve juridiksionale si dhe të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe që janë objekt ratifikimi nga parlamenti shqiptar.
- Kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me sistemin gjyqësor dhe atë të drejtësisë në përgjithësi.
- Drejton dhe kontrollon administratën gjyqësore.
- Kryen inspektime dhe bën procedimin disiplinor të gjyqtareve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit sipas ligjit.
- Drejton sistemin e ekzekutimit të vendimeve civile dhe të titujve ekzekutive.
- Mbikëqyr, mbështet dhe bashkëpunon për procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, që realizohet nga Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave.
- Drejton veprimtarinë e Qendrës së Publikimeve Zyrtare.
- Drejton shërbimin e unifikuar statistikor në fushën e Drejtësisë.
- Mban regjistrin e gjendjes gjyqësore dhe lëshon certifikatat në bazë të atij regjistrimi sipas legjislacionit në fuqi.
- Shqyrton dhe trajton kërkesat për përfitimin e dëmshpërblimit të ish të dënuarve politik.
- Realizon shërbimet juridiko-administrative që sipas ligjit janë në kompetencë të Ministrit të Drejtësisë.
- Kujdeset për realizimin dhe bashkërendimin e veprimtarive në fushën e drejtësisë për të miturit, për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshme të tyre, edukimin ligjor dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit nga ana e tyre si dhe për ushtrimin e shërbimeve ndaj të miturve nga strukturat përkatëse të sistemit të drejtësisë.

- Kujdeset dhe mbështet sipas ligjit ushtrimin, organizimin dhe funksionimin e profesioneve të lira të lidhura me sistemin e drejtësisë.
- Mbikëqyr dhe drejton organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit dhe të institucioneve të vuajtjes së dënimit.
- Mbikëqyr dhe drejton aktivitetin e zyrave të regjistrimit të pronave të paluajtshme.

Në marrëdhëniet me prokurorinë, Ministria e Drejtësisë ushtron kontroll sipas ligjit mbi organin e prokurorisë dhe mbi respektimin e parimeve të drejtësisë dhe barazisë. Po ashtu, brenda datës 31 mars të çdo viti, Ministri i Drejtësisë i paraqet, në emër të Këshillit të Ministrave, rekomandimet përkatëse Prokurorit të Përgjithshëm për luftën kundër kriminalitetit.

Sipas Kushtetutës, Ministri i Drejtësisë është përfaqësuesi i vetëm i Këshillit të Ministrave, anëtar i KLD-se. Po ashtu, Ministri i Drejtësisë ka të drejte të fillojë inspektime ndaj gjyqtarëve, në rast ankimi ose mbi bazë tematike apo territoriale. Këto inspektime zhvillohen me iniciativën e tij ose në zbatim të detyrave të caktuara nga KLD.

2 Dokumente strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e drejtësisë

Strategjia sektoriale e drejtësisë është duke u rishikuar nga Ministria e Drejtësisë, dhe do të dorëzohet në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave në fund të muajit prill 2008. Më pas dokumenti do të konsultohet me grupet e interesit dhe do të ndjekë procedurat për miratim në Këshillin e Ministrave.

Strategjia ndërsektoriale e të drejtave të pronës

Strategjia e ndërsektoriale e të drejtave të pronës është duke u rishikuar dhe një draft i përpunuar është dërguar në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave. Gjithashtu janë kërkuar mendimet e institucioneve të përfshira në këtë strategji në përputhje me urdhërin Nr. 169, datë 27.07.2006 për ngritjen e Grupit Ndërmintor të Punës për hartimin e kësaj strategjie. Drafti i konsoliduar do të konsultohet me grupet e interesit dhe më pas do të ndjekë procedurat për miratim në Këshillin e Ministrave.

Qëllimet

Politika e këtyre strategjive është hartuar në funksion të arritjes së qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Harmonizimi dhe reformimi i legjislacionit shqiptar, përmirësimi i shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe shërbimeve të lira juridike (rritja e profesionalizmit, transparencës dhe pavarësisë).
- Transparenca e normave ligjore dhe rritja e aksesit të publikut në normat juridike.
- Njohja më e mirë e mirë e legjislacionit me qëllim zbatimin e tyre.
- Përmirësimi i cilësisë së ekspertimeve mjeko-ligjore duke u përafëruar me standartet metodike dhe tekniko-shkencore të instituteve analoge të Bashkimit Europian.
- Rritja e performancës së Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor duke bërë të mundur; zbatimin sa më korrekt të ligjit në trajtimin e të gjithë kompleksitetit të çështjeve përmbarimore. Respektimin e afateve ligjore.
- Përmirësimin e kushteve të jetesës së të burgosurve, integrimin e të burgosurve nëpërmjet punësimit dhe ndërgjegjësimit të tyre, sikurse dhe përmirësimin e trajtimit të tyre nga personeli i burgjeve, duke rritur elementët e sigurisë dhe duke u përshtatur plotësisht me konventat ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të të dënuarve.
- Profesionalizëm në përzgjedhje, të një familje të ardhshme birësuese, në interes të fëmijës nëpërmjet një vlerësimi sa më objektiv të gjendjes psiko-sociale dhe emocionale të familjes birësuese.
- Sigurimin e një mbrojtje më eficiente të interesave shtetërore në proceset gjyqësore.
- Garantimi i titujve të pronësisë mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në të gjithë Shqipërinë, nëpërmjet një sistemi të sigurt, efikas, bashkëkohor të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme
- Realizimi i procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave subjekteve të shpronësuara, në një kohë sa më të shkurtër, duke synuar kthimin fizik të pronës në kufinj të maksimal aty ku është e mundur dhe në pamundësi, kompensimin e saj sipas formave të përcaktuara në ligj (kompensim fizik & kompensim financiar).

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi konsiston në realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë, në përputhje me ligjin. Ministria e Drejtësisë mbështet dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me organet e pushtetit gjyqësor dhe me prokurorinë, kujdeset, drejton dhe kontrollon, sipas ligjit, institucionet e varësisë si dhe shërbimet juridiko-administrative të lidhura me veprimtarinë e saj.

3.2 PUBLIKIMET ZYRTARE

Politika e këtij programi konsiston në publikimin në kohën më të shkurtër të normave ligjore, duke rritur aksesin e publikut në ligj dhe transparencën e normave juridike për një zbatim sa më të mirë të tyre.

3.3 MJEKËSIA LIGJORE

Politika e këtij programi konsiston në sigurimin dhe përshtatshmerinë në një kohë sa më të shpejtë të shërbimit mjeko-ligjor në të gjithë territorin e Republikës, në dobi të gjykatës, prokurorisë dhe policisë. Kjo do të arrihet përmes përvetësimit të metodave të reja tekniko-shkencore, kualifikimeve të specialistëve, përmirësimit të kushteve në laboratore dhe të pajisjeve me aparatura të reja.

3.4 SHËRBIMI I PËRMBARIMIT GJYQËSOR

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor nëpërmjet kompletimit të infrastrukturës, logjistikës dhe rritjes profesionale të punonjësve.

3.5 SHËRBIME PËR ÇËSHTJET E BIRËSIMIT

Politika e këtij programi konsiston në sistemimin e të miturve të braktisur në një ambient të ngrohtë familjar.

3.6 REGJISTRIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një shërbimi të shpejtë ndaj qytetarëve dhe institucioneve shqiptare në lidhje me regjistrimin e të drejtave mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në të gjithë territorin e Shqipërisë, si dhe për dhënien e informacionit mbi këto pasuri, nëpërmjet një sistemi regjistrimi të pasurive të paluajtshme efikas, bashkëkohor, që siguron informacion të qartë, të saktë, të përditësuar, të sigurt, transparent mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në Shqipëri.

3.7 SHËRBIMI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE

Politika e këtij programi konsiston në realizimin e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave subjekteve të shpronësuar, në një kohë sa më të shkurtër, duke synuar kthimin fizik të pronës në kufinj të maksimal aty ku është e mundur dhe në pamundësi, kompensimin e saj sipas formave të përcaktuara në ligj (kompensim fizik & kompensim financiar).

3.8 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Politika e këtij programi konsiston në trajtimin e të burgosurve, sipas standarteve.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2008.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës:

- Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë nëpërmjet rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të inspektimeve të sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë.
- Rritja e numrit të inspektimeve krahasuar me vitin paraardhës me qëllim përmirësimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë.
- Harmonizimi dhe reformimi i legjislacionit shqiptar në përputhje me standartet e BE.
- Bashkëpunimi ndërgjyqësor nëpërmjet zbatimit të akteve ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar me qëllim intensifikimin e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja të drejtësisë dhe ato shqiptare si dhe përkthimi i akteve zyrtare, akteve ndërkombëtare dhe certifikimi i tyre, si dhe i akteve ndërkombëtare të mëparshme të papërkthyer ose të përkthyer jo në standartet e kërkuara.
- Përmirësimi i kushteve të punës në gjykatat e rretheve gjyqësore nëpërmjet rehabilitimit të tyre, si dhe ndërtimit të gjykatave të reja, në kuadrin e projekteve të BE- së.
- Verifikimin dhe shqyrtimin e kërkesave për përfitimin e dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politik të paraqitur pranë Ministrisë së Drejtësisë duke bashkërenduar punën me institucionet e tjera të përcaktuara në ligj si dhe përcaktimi i masës së dëmshpërblimit duke bërë propozimin përkatës për përfitimin e këtij dëmshpërblimi.
- Trajnimi i stafit për zbatimin e standarteve të reja ligjore dhe institucionale (mesatarisht 100 punonjës, duke përfshirë edhe trajnimin e një pjese të stafit të institucioneve të varësisë).
- Sigurimi i lidhjes online me të gjitha njësitë qendrore dhe vartëse që veprojnë në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë.

Produktet që do të ofrohen :

- Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të inspektimeve të sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë
- Intensifikimi i luftës kundër korrupsionit dhe rritja e transparencës .
- Përmirësim në hartimin e akteve ligjore.
- Realizimi efektiv i marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe në një standart më të lartë si dhe realizimi i përkthimit zyrtar më cilësor.
- Mbështetje e infrastrukturës së sistemit të drejtësisë.
- Përcaktimi i numrit të kërkesave që përfitojnë dëmshpërblim si dhe përcaktimi i masës në lek të dëmshpërblimit.
- Rritja e cilësisë dhe efikasitetit të punës në Ministrinë e Drejtësisë dhe Institucionet e Varësisë .

4.2 PUBLIKIMET ZYRTARE

Objektivat e politikës:

- Rritja e numrit të publikimeve zyrtare (220 Fletore Zyrtare, 20 botime), përmirësimi i kushteve të punonjësve.

- Rritja e shpejtësisë së publikimit të akteve zyrtare (brenda dy ditëve).
- Rritja e aksesit të publikut në ligj nëpërmjet rritjes së numrit të vizitorëve në faqen Eëb.

Produktet që do të ofrohen

- Publikimi i fletores zyrtare.
- Botime të tjera.
- Publikim në internet.
- Publikim në gjuhë të huaj.

4.3 MJEKËSIA LIGJORE

Objektivat e politikës:

- Përmirësimi i kushteve të punës në sektorin e ekspertimeve ligjore, përmes krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin e këtij aktiviteti .
- Kompjuterizimi dhe dixhitalizimi i sallës së autopsisë dhe i mjediseve të tjera.
- Rikonstruksioni i një ambjenti të përshtatshëm për mbajtjen e reagentëve dhe materialeve të tjera laboratorike.

Produktet që do të ofrohen

- Aktet e ekspertimit mjeko-ligjor, toksikologo-ligjor, psikiatër-ligjor dhe biologo-ligjor në përputhje me metodat e fundit tekniko - shkencore.

4.4 SHËRBIMI I PËRMBARIMIT GJYQËSOR

Objektivat e politikës:

- Krijimi i një rrjeti të brendshëm të dixhitalizuar interneti për të gjithë sistemin e Shërbimit Përmbarrimor.
- Përmirësimi i shërbimit ndaj popullatës duke krijuar bankën e të dhënave në Zyrat Përmbarrimore nëpërmjet Software-it.
- Plotësimi i Zyrave Përmbarrimore me pajisjet e nevojshme.

Produktet që do të ofrohen

- Ekzekutimi i shpejtë i titujve ekzekutiv.
- Përmirësimi i kushteve të punës të përmbarruesve gjyqësorë.
-

4.5 SHËRBIME PËR ÇËSHTJET E BIRËSIMIT

Objektivat e politikës:

- Sistemimi i 60 fëmijëve të braktisur.
- Rritja kualitative e shërbimeve të Komitetit Shqiptar të Birësimeve dhe afrimi i tyre me standartet më të përparuara.

Produktet që do të ofrohen

- 60 birësime të realizuara.
- Një shërbim i përmirësuar cilësisht dhe në kohë.

4.6 REGJISTRIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME

Objektivat e politikës:

- Përmirësimi i dhënies së shërbimeve të ZRPP në të gjithë Shqipërinë.
- Regjistrimi fillestar i Pasurive të Paluajtshme.
- Zhvillimi i mëtejshëm i kuadrit rregullator.
- Ngritja e kapaciteteve të administratës nëpërmjet trajnimeve të tyre.

Produktet që do të ofrohen:

- Regjistrimi i 50 000 pasuri të paluajtshme.
- Sistem i automatizuar i regjistrimit të pasurive të paluajtshme në dy Zyra Regjistrimi
- Legjislacion i përmirësuar dhe i ndryshuar për regjistrimin e pasurive të paluajtshme (2 akte të paraqitura, të miratuara).
- Staf i trajnuar në të gjithë sistemin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (100 punonjës)
- Shërbime të kryera nga ZRPP, në lidhje me regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe të drejtave mbi to (700 000 shërbime).
- Klientë të informuar për funksionimin dhe shërbimin e ZRPP (1 000 000 shtetas)
- Zyra të rinovuara, të zgjeruara, të pajisura.
- Sistem bashkëkohor për mbrojtjen nga zjarri i ngritur në ZQRPP dhe në 9 ZVRPP
- Pajisje zyre të blera
- Pajisje kompjuterike të blera
- Pajisje të tjera të blera për nevoja pune për ZRPP

4.7 SHËRBIMI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE

Objektivat e politikës:

- Informatizimi i arkivave në qendër dhe në 12 qarqe (ku do të përcaktohen saktë të dhënat për kompensim fizik dhe financiar të pronës).
- Rivlerësimi i hartës së vlerës së tokës për të gjithë teritorin e Shqipërisë për kompensim financiar.
- Kompensim financiar (në të holla) sipas procedurave që do të miratohen nga K.M.
- Krijimi i fondit për kompensim fizik(objekte, sipërfaqe të lira etj.)
- Propozime për ndryshimin e VKM-ve, normuese të procesit të kthimit dhe kompesimit të pronave.
- Rritja e vendimmarrjes dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për mbylljen sa më shpejt të procesit të njohjes, kthimit dhe kompesimit të pronave.

Produktet që do të ofrohen:

- Kthimi dhe kompensimi i pronave
- Njohja e të drejtës së parablerjes.

4.8 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Objektivat e politikës:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe rritja e kualifikimit të stafit civil dhe policor, prej afro 800 personash.
- Respektimi i konventave nderkombetare lidhur me standartet për ngritjen dhe drejtimin e institucioneve penitenciare.
- Përmirësimi i kushteve nëpërmjet rikonstruksionit të godinave ekzistuese në Burrel, Spitali i burgut Tiranë, Rogozhinë, Vaqarr, Burgu 325.
- Përmirësimi i kushteve të jetesës për të burgosurit në institucionet e vuajtjes së dënimit .
- Zgjerimi i ambienteve në I.E.V.P nëpërmjet rikonstruksioneve në Sarandë, Berat, Kukës Tropojë.
- Ndërtime të reja në I.E.V.P Durrës, Instituti i Riedukimit të të miturve në Kavajë.
- Hapjen e shpejtë të I.E.V.P të reja në Vlorë, F. Krujë, Korçë si dhe përzgjedhja e stafit policor dhe civil të kualifikuar që përmbush kriteret e përcaktuara.
- Sigurimi i linjave të dyta të furnizimit me energji elektrike në I.E.V.P F. Krujë, Krujë (Zahari), Lezhë, Vlorë me qëllim përmirësimin e kushteve.
- Rritja e elementeve të sistemit të sigurisë në sistemin e burgjeve nëpërmjet vendosjes së 10 skanerave dhe sistemit të vëzhgimit në Korçë, Durrës dhe F. Krujë.
- Përmirësimi i rrjetit të të dhënave mbi trajtimin e të burgosurve në të gjithë sistemin e burgjeve.
- Përmirësimi i trajtimit shëndetësor të të burgosurve nëpërmjet blerjes së pajisjeve shëndetësore.
- Menaxhimi i burimeve financiare nëpërmjet auditeve të kryera në sistemin e burgjeve(5 audite).
- Kompjuterizimi i sistemit të kontabilitetit, me programet përkatëse.

Produktet që do të ofrohen:

- Blerje pajisjesh kompjuterike për transferim të dhënash në DPB.
- Pajisje shëndetësore për sistemin e burgjeve.
- Ndërtimi i një I.E.V.P të ri në Durrës.
- Administrim dhe monitorim i sistemit të burgjeve.
- Rikonstruksion i I.E.V.P Burrel.

- Rikonstruksion i spitalit të Burgut Tiranë.
- Rikonstruksion në I.E.V.P 325 "Ali Demi" Tiranë.
- Rikonstruksion i I.E.V.P Rrogozhinë.
- Rikonstruksion i I.E.V.P Vaqarr.
- Rikonstruksion i I.E.V.P Tropojë.
- Rikonstruksion në I.E.V.P në Sarandë.
- Rikonstruksion në I.E.V.P Berat.
- Rikonstruksion i I.E.V.P Kukës.
- Pajisje gazermimi dhe pajisje elektrike në gjithë sistemin e burgjeve .
- Paisja me sistem vëzhgues.
- Linjë e re elektrike për I.E.V.P Vlorë.
- Linjë e dytë elektrike për I.E.V.P F. Krujë.
- Pikë lidhje elektrike në I.E.V.P Krujë.

Tabela Buxheti 2008 sipas programeve dhe llojeve të shpenzimeve, milion Lek

| Programet | Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqërore 600, 601 | Mallra dhe shërbime 602 | Subveconet 603 | Të tjera transferata korrente 604, 605 | Transferata për buxhetet familiare dhe individët 606 | Shpenzime kapitale 230, 231 | Total |
|--|--|-------------------------|----------------|--|--|-----------------------------|--------------|
| Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 164 | 68 | 0 | 7 | 0 | 573 | 812 |
| Publikimet Zyrtare | 15 | 19 | 0 | 0 | 0 | 22,5 | 56,5 |
| Mjekësia Ligjore | 32 | 13 | 0 | 0 | 0 | 11,5 | 56,5 |
| Sistemi i Burgjeve | 2,185 | 685 | 0 | 0 | 0 | 550 | 3,420 |
| Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor | 141 | 40 | 0 | 0 | 0 | 10 | 191 |
| Shërbimet për çështjet e birësimeve | 7 | 5.5 | 0 | 0 | 0 | 0.500 | 13 |
| Shërbimi i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme | 342 | 85 | 0 | 0 | 0 | 517 | 944 |
| Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave | 149 | 31 | 0 | 0 | 500 | 4 | 684 |
| Total | 3,035 | 946,5 | 0 | 7 | 500 | 1,688 | 6,176 |

5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2008.

| Treguesit | Njësia | Qellimi |
|--|---|---|
| Një kuadër ligjor që do të përmbushë kërkesat e një shërbimi cilësor ndaj qytetarëve si dhe harmonizimi i legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe veçanërisht me ato komunitare | Nr. aktesh | 16 |
| Kontrolle për respektimin e ligjit procedural gjatë ushtrimit të veprimtarisë së pushtetit gjyqësor dhe organit të prokurorisë si dhe kontrolle e mbikëqyrje të veprimtarisë së institucioneve të varësisë të MD në zbatim të ligjeve përkatëse. | Nr. kontrollesh realizuara | të 8 në gjyqësor 9 në prokurori |
| Zbatimi i akteve ndërkombëtare dhe të legjislacionit shqiptar me qëllim intesifikimin e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja të drejtësisë dhe ato shqiptare | | Ratifikimi i Konventës së Hagës: “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja për çështjet civile dhe tregëtare” e 1 Shkurtit 1971, si dhe “Mbi procedurën civile” e 1 Marsit 1954. |
| Verifikimi dhe shqyrtimi i kërkesave për përfitimin e dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politik si dhe përcaktimi i masës së dëmshpërblimit duke bërë propozimin përkatës për përfitimin e këtij dëmshpërblimi | % e kërkesa të paraqitura për dëmshpërblim kundrejt totalit | për 99-100% (afati i pranimit të tyre përfundon në 19.12.2008) |
| Përmbushja e shpejtë dhe efiçente e interesave pasurore të shtetasve përmes ekzekutimit me sukses të titujve ekzekutivë në kohë dhe me cilësi | | Përgatitja e projekt draftit “Për liberalizimin e shërbimit përbarimor gjyqësor për kategori të veçanta të titujve ekzekutivë” |
| Përmirësimi i kushteve të jetesës të të burgosurve si dhe përmirësimi i elementeve të sigurisë përmes ndërtimit dhe rikonstruksionit të sistemit të paraburgimit si dhe institucioneve të vuajtjes së dënimit | Nr. i investimeve të kryera në fushë | 16 investime publike dhe te huaja |
| Përsheptimi i procesit të kthimit dhe kompesimit të pronave | Vendime të marra për kthim dhe kompesim | Rreth 5000 |
| Vazhdimi i regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme | Nr. pasurish të regjistruara | të 50.000 |
| Profesionalizmi i stafit në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimit, komunikimit dhe etikës nëpërmjet trajnimit të stafit | Nr. punonjësish të trajnuar | të 100-110 |
| Transparencë me publikun për proceset e ndjekura nga Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e varësisë | | Funksioni i faqes së internetit të MD dhe institucioneve të varësisë |

Aneks 1 Projekt-ligjet për tu paraqitur

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbartimor”.
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal”.
- Projektligji “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale dhe Civile”
- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin “Për autopsinë”
- Projektligji “Për përkthyesit zyrtar”.
- Projektligji “Për administratën gjyqësore”
- Fillimi i procedurës së ratifikimit të Konventës së Hagës për njohjen e zbatimit të vendimeve mbi detyrimin ushqimor; Fillimi i procedurës së ratifikimit të Konventës së Hagës për njohjen e divorcit dhe ndarjes ligjore.
- Konventa e KE mbi moszbatueshmërinë e legjislacionit të brendshëm për krime kundër njerëzimit dhe krime të luftës; Projektligj për ratifikimin e Konventës së Hagës “Mbi procedurën civile” e 1 Marsit 1954.
- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin “Për noterinë”.
- Projektligji “Për te drejtën ndërkombëtare private”.
- Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”.
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Civil”.
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për policinë e burgjeve”.
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” në bashkëpunim me aktorët e interesit.
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e KLD” në bashkëpunim me aktorët e interesit.
- Projektligji “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 7843 datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, në funksion të kalimit të ZRPP në institucion vetëfinancues.
- Projektvendimi “Për ndryshimin e VKM nr. 549, datë 26.08.1996 “Për caktimin e tarifave të shërbimit të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin European

- Disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Etikës të Përmbaruesit Gjyqësor.
- Projektimi dhe ndërtimi i I.E.V.P në Tirane, Kukës, Shkodër dhe Gjirokastrë; ndërtimi i I.E.V.P (paraburgimit) të ri në Rr.”Jordan Misja” dhe shtesë ambjentesh në I.E.V.P Rrogozhinë.
- Ngritja ose adaptimi i ndërtesës që do të shërbejë si akademi e personelit të burgjeve.
- Krijimi i një zyre të veçante për magjistratët ndërlidhës.
- Realizimi i një sistemi të veçante për punësimin e të burgosurve.
- Shtrirja e arsimit 9 vjeçar në të gjitha Institucionet e ekzekutimit të vuajtes së dënimit.
- Përcaktimi i rregullave për zbatimin e sistemit të administrimit të çështjeve (PP) dhe kompjuterizimi i përpunimit të dosjeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës, si për çështjet civile ashtu edhe ato penale.
- Miratimi i Projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8730 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor”.
- Informatizimi i të dhënave mbi trajnimin e të burgosurve duke përfshirë programin, pajisjet dhe trajnimin e personelit.
- Projektligji “Për administratën gjyqësore”.
- Realizimi i diagnostifikimit të burgosurve.
- Miratimi i projektligjit “Për të drejtën ndërkombëtare private”.
- Publikimi i raporteve të kontrollit në gjykata dhe prokurori.
- Vënia në efikasitet të plotë të I.E.V.P dhe spitalit të sëmurëve mendorë në Durrës.
- Projektligjet për rishikimin dhe harmonizimin e të gjitha ligjeve organike të drejtësisë.
- Reformimi dhe rimodelimi i prokurorisë dhe marrëdhëniet e saj me pushtetet e tjera.
- Përfundimi i punës përgatitore për sistemin e pozicionimit global në të gjitha pikat e territorit të vendit lidhur me dixhitalizimin e ZVRPP-ve. .
- Trajnimi i administratës gjyqësore nëpërmjet programit të bashkëpunimit midis Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës.
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, date 21.03.1995, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”.
- Miratimi i projektligjit të ri “Për bashkëpunimin gjyqësor në fushën penale”.
- Programimi vjetor i kontroleve në gjykata, lidhur me realizimin e marrëdhënieve me publikun, aksesin e qytetarëve në gjykatë dhe në vendimet gjyqësore.
- Projektligji “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 7843 datë 13.07.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, në funksion të kalimit të ZRPP në institucion vetëfinancues.
- Projektvendimi “Për ndryshimin e VKM nr. 549, datë 26.08.1996 “Për caktimin e tarifave të shërbimit të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.
- Regjistrimi i 50 000 pasurive të paluajtshme në zonat urbane.

Aneks 3 Investimet publike

TABELA E DETAJUAR SIPA INSTITUCIONEVE TE INVESTIMEVE PËR VITIN 2008 PËR SISTEMIN E DREJTËSISË

| Insititucioni Përfitues | Shuma në lekë | Burimi i investimit | Emërtimi i projektit |
|---------------------------------|---------------|-----------------------|--|
| Aparati i Ministrisë | 1.600.000 | Investime nga Buxheti | Leje ndertimi nga Bashkia |
| Aparati i Ministrisë | 5.000.000 | Investime nga Buxheti | Lidhja me rrjetet online e Sistemit të Drejtësisë |
| Aparati i Ministrisë | 4.000.000 | Investime nga Buxheti | Pajisje kompjuterike, pajisje zyre e pajisje të tjera |
| Aparati i Ministrisë | 1.500.000 | Investime nga Buxheti | Investime për IT |
| Aparati i Ministrisë | 102 .000.000 | Investime nga Buxheti | Korpusi administrative dhe arkiva e Sistemit te Drejtësisë |
| Aparati i Ministrisë | 5.440.000 | Investime nga Buxheti | T.V.SH. dhe taksa doganore |
| Avokatura e Shtetit | 4.000.000 | Investime nga Buxheti | Pajisje kompjuterike dhe pajisje të tjera për avokaturën |
| Publikimet Zyrtare | 500.000 | Investime nga Buxheti | Pajisje zyre të ndryshme |
| Publikimet Zyrtare | 4.000.000 | Investime nga Buxheti | T.V.SH. dhe taksa doganore për programin CARDS |
| Mjekësia Ligjore | 3.000.000 | Investime nga Buxheti | Pajisje për morgun |
| Mjekësia Ligjore | 2.000.000 | Investime nga Buxheti | Pajisje kompjuterike |
| Mjekësia Ligjore | 1.500.000 | Investime nga Buxheti | Pajisje zyre për laboratorin |
| Mjekësia Ligjore | 5.000.000 | Investime nga Buxheti | Konfigurimi dhe dixhitalizimi |
| Biresimet | 500.000 | Investime nga Buxheti | Pajisje te ndryshme |
| Kthimi dhe Kompensimi i Pronave | 4.000.000 | Investime nga Buxheti | Pajisje zyrash |
| Permbarimi | 10.000.000 | Investime nga Buxheti | Rikonstruksion dhe përshtatje ambjentesh të marra rishtazi për Drejtorin e Përgjithshëm të Përmbarimit |
| Zyra Qendrore e R.P.P | 1.000.000 | Investime nga Buxheti | Blerje autoveturash |
| Zyra Qendrore e R.P.P | 3.000.000 | Investime nga Buxheti | Blerje pajisje kompjuterike |
| Zyra Qendrore e R.P.P | 900.000 | Investime nga Buxheti | Blerje Pajisje të tjera zyre |
| Zyra Qendrore e R.P.P | 2.000.000 | Investime nga Buxheti | Blerje orendi zyre |

Plani i Integruar i Ministrisë

| | | | |
|-----------------------|--------------------|-----------------------|---|
| Zyra Qendrore e R.P.P | 3.000.000 | Investime nga Buxheti | Blerje pajisje fotokopjues |
| Zyra Qendrore e R.P.P | 7.100.000 | Investime nga Buxheti | Blerje pajisjesh për mbrojtjen nga zjarri |
| Sistemi i Burgjeve | 12.200.000 | Investime nga Buxheti | Studim Projektimi |
| Sistemi i Burgjeve | 32.800.000 | Investime nga Buxheti | Ndërtimi i I.E.V.P Durrës dhe spitalit të sëmurëve mendor me mjekim të detyruar |
| Sistemi i Burgjeve | 18.000.000 | Investime nga Buxheti | Rikonstruksion i I.E.V.P Burrel |
| Sistemi i Burgjeve | 21.000.000 | Investime nga Buxheti | Rikonstruksion Spitalit të Burgut Tiranë |
| Sistemi i Burgjeve | 13.000.000 | Investime nga Buxheti | Rikonstruksion I.E.V.P 352 Tiranë |
| Sistemi i Burgjeve | 9.200.000 | Investime nga Buxheti | Rikonstruksion I.E.V.P Rrogozhinë |
| Sistemi i Burgjeve | 3.500.000 | Investime nga Buxheti | Rikonstruksion I.E.V.P Vaqarr |
| Sistemi i Burgjeve | 10.000.000 | Investime nga Buxheti | Rikonstruksion I.E.V.P Sarandë |
| Sistemi i Burgjeve | 13.000.000 | Investime nga Buxheti | Rikonstruksion I.E.V.P Kukës |
| Sistemi i Burgjeve | 13.000.000 | Investime nga Buxheti | Rikonstruksion I.E.V.P Berat |
| Sistemi i Burgjeve | 11.000.000 | Investime nga Buxheti | Rikonstruksion I.E.V.P Tropoje |
| Sistemi i Burgjeve | 11.500.000 | Investime nga Buxheti | Linja e dytë elektrike I.E.V.P Vlorë |
| Sistemi i Burgjeve | 11.000.000 | Investime nga Buxheti | Linja e dytë elektrike në I.E.V.P i ri Fushë-Krujë |
| Sistemi i Burgjeve | 3.500.000 | Investime nga Buxheti | Pike lidhje e dytë I.E.V.P Fushë-Krujë |
| Sistemi i Burgjeve | 175.300.000 | Investime nga Buxheti | Pajisje të ndryshme(Pajisje policie, për të dënuar, pajisje zyre) |
| Sistemi i Burgjeve | 32.000.000 | Investime nga Buxheti | T.V.SH. dhe taksa doganore për programin CARDS |
| TOTALI | 556.040.000 | | |

Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

TABELA E DETAJUAR SIPAS INSTITUCIONEVE TE INVESTIMEVE PËR VITIN 2008 PËR SISTEMIN E DREJTËSISË

| Insititucioni PËrfitues | Shuma në lekë | Burimi i investimit | Emërtimi i projektit |
|-------------------------|---------------|---------------------|--|
| Sistemi i Drejtësisë | 123.80.000 | Investime të Huaja | Euralius |
| Sistemi i Drejtësisë | 90.624.000 | Investime të Huaja | Ndërtimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda - BE |
| Sistemi i Drejtësisë | 61.530.000 | Investime të Huaja | Pajisje për gjykatën dhe prokurorinë e krimeve të rënda - BE |
| Sistemi i Drejtësisë | 24.616.000 | Investime të Huaja | Rinovimi i Gjykatave Dibër dhe Sarandë - BE |
| Sistemi i Drejtësisë | 100.000.000 | Investime të Huaja | Trajnim dhe pajisje për administratën gjyqësore - BE |
| Publikimet Zyrtare | 18.450.000 | Investime të Huaja | Mbështetje për Q.P.Z CARDS - BE |
| Zyra Qendrore e R.P.P | 3.000.000 | Investime të Huaja | Regjistrimi I të drejtave të P.P. - BB |
| Zyra Qendrore e R.P.P | 497.000.000 | Investime të Huaja | Regjistrimi I të drejtave të P.P. - BB |
| Sistemi i Burgjeve | 36.920.000 | Investime të Huaja | CARDS Ndërtimi i Institutit Riedukimit për të mitur - BE |
| Sistemi i Burgjeve | 123.080.000 | Investime të Huaja | Ndertimi i I.E.V.P Elbasan dhe Vlorë - BE |

Aneks 5 Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit

Disa nga problemet me shqetësuese në sistemin e drejtësisë lidhen me transparencën e ulët të proceseve penale dhe civile të drejtësisë, cka ka sjelle shkallë të ulët besueshmërie të publikut në sistemin gjyqësor; mungesën e transparencës dhe procedurat jo objektive të emërimit të gjyqtareve e prokurorëve; mangësitë në statusin, pavaresinë dhe mbrojtjen e posaçme që u sigurohet gjyqtareve; mangësitë infrastrukturore në gjykata, prokurori, burgje, dhoma paraburgimi, etj.; mungesa e statusit dhe pagat e ulëta të stafit administrativ të gjykatave; shkalla jo e kënaqshme e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Prioriteti kryesor në këtë sistem është rritja e shkallës së besueshmërisë së publikut të drejtësisë nëpërmjet krijimit të një sistemi gjyqësor të pavarur; transparent; të përgjegjshëm dhe eficient.

Masat kryesore që do të merren gjatë vitit 2008 për të luftuar fenomenin e korrupsionit janë:

Në sistemin gjyqësor

- Fuqizimi i institucioneve të vetëkontrollit dhe administrimit të sistemit të drejtësisë;
- Forcimi i inspektorateve dhe mbështetja me bazën e duhur ligjore për matjen e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve;
- Sigurimi i publikimit të raporteve të inspektorateve;
- Standardizimi i dosjes gjyqësore (civile e penale);
- Përcaktimi i statusit të administratës gjyqësore;
- Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në gjykata dhe forcimi i mirëadministrimit të drejtësisë;
- Zgjerimi i automatizimit të sistemit të administrimit të çështjeve në gjykatat e apelit dhe të shkallës së parë;
- Zbatimi i një sistemi të ri kalendarimi për shkurtrimin e kohës së trajtimit të çështjeve
- Gjenerimi automatik i raporteve të performancës së çdo gjykate dhe çështjeve të mbetura apo në proces;
- Zhvillimi i një sistemi IT në gjyqësor, në përbërje të të cilit do të jenë e-justice, sistemi i integruar i informacionit për luftën kundër krimit, menaxhimit të çështjeve dhe I.E.V.P
- Përcaktimi i afateve të proceseve gjyqësore ;
- Ngritja dhe funksionimi i një njësie të veçantë që do të merret me arkivimin e dokumenteve elektronike në sektorin gjyqësor (me dokumente elektronike do të kuptohen tekste, materiale video dhe audio, në forme dixhitale) e cila do t'i shërbejë publikut të interesuar në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës për komunikim të drejtëpërdrejtë në rrugë elektronike;

Reformimi e konsolidimi i sistemit të përmbartimit

- Rritja e efektivitetit në sistemin e përmbartimit gjyqësor;
- Krijimi dhe zbatimi i praktikave të unifikuara dhe përmirësimi i legjislacionit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në nivelet mesatare të BE-së;
- Licencimi i operatorëve privatë në këtë fushë;
- Krijimi i një rrjeti të brendshëm dixhital për gjithë sistemin e shërbimit përmbartimor (afatmesme);
- Ekzekutimi i përgjegjshëm i vendimeve gjyqësore;
- Shqyrtimi i shpejtë i ankesave të qytetarëve ndaj përmbartuesve dhe marrja e masave disiplinore ndaj përmbartuesve që abuzojnë me detyrën.

Reforma e të drejtës së pronësisë

- Përcaktimi i procedurave të qarta për regjistrimin e pasurive të paluajtshme;
- Miratimi i rregullores së brendshme të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
- Modernizimi dhe shtrirja e informatizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në 10 zyrat e mëdha;
- Transparenca dhe integriteti në zbatimin e reformës së kthimit e kompensimit të pronave të paluajtshme.
- Përcaktimi i procedurave të hollësishme, mbi trajtimin e kërkesave dhe ankimeve në AKKP dhe ZRAKKP-të në qarqe.
- Informatizimi dhe dixhitalizimi i arkivës dhe vendimmarrjes aktuale të AKKP dhe ZRAKKP - të në qarqe.
- Zgjerimi i kapaciteteve vetkontrolluese të institucionit të AKKP-së.